

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në prag të Asamblesë së OKB-së, Trump takohet me Macron në Nju Jork
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/ne-prag-te-asamblese-se-okb-se-trump-takohet-me-macron-n-e-nju-jork-i587367
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	21 shtator 2026, 06:22:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 06:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9925e24ec251e1fb7df5a731e0a0a345441291f1a2f23bc1cfe18638e127275
TEKSTI	54063451f35c11f742e59c8b392df39cc323b78a527516771c8a2de4cb5f526c
PAMJA	4af93990b29615d083a2fd656c684353eb5825378a4fdd9743e152892c06eb29

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	598af0c50f236bc55832079b4be35628b8f7e880eb921afa57d702e29b40d2ba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af35c6566c3aad3783a58e2d1a9e53ca15a19073105bf934d046e340151e749d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/598af0c50f236bc55832079b4be35628b8f7e880eb921afa57d702e29b40d2ba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le [Studentet marshojne sot ne Prishtine kunder vendimit te Speciales, thirrje per unitet dhe drejtesi](#)[Aksident me vdekje ne aksin Eibasan-Peqin](#)[Atentati ne Sarande/ Dysheo](#)
fundit

Në prag të Asamblesë së OKB-së, Trump takohet me Macron në Nju Jork



21 Shtator 2026, 08:40Bota TEMA



Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, do të takohet këtë pasdite me homologun e tij francez, Emmanuel Macron, në Nju Jork, ku të dy liderët ndodhen për të marrë pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Takimi është planifikuar për orën 17:35 me orën lokale, sipas agjendës së publikuar nga Shtëpia e Bardhë. Biseda mes dy liderëve pritet të përqendrohet në zhvillimet ndërkombëtare dhe disa prej krizave kryesore me të cilat përballlet komuniteti ndërkombëtar.

Trump do të takohet më herët me Zoran Mamdanin, kryetarin e bashkisë së Nju Jorkut, i cili i përket krahut të majtë të Partisë Demokratike dhe ka kundërshtuar disa prej politikave të presidentit amerikan.

Ndërkohë, Macron mbërrin në Nju Jork nga Saint-Pierre-et-Miquelon, territori francez në Atlantikun e Veriut, ku të dielën u takua me kryeministrin kanadez Mark Carney.

Gjatë takimit, Macron dhe Carney mbrojtën sovranitetin kombëtar të vendeve të tyre dhe kërkuan forcimin e marrëdhënieve mes Francës dhe Kanadasë. Takimi u zhvillua në një kohë kur Trump ka bërë vazhdimisht deklarata lidhur me Kanadanë, përfshirë kërcënime për aneksimin e saj.

Në Nju Jork, Macron pritet të zhvillojë edhe një sërë takimesh dypalëshe. Përveç Trump, presidenti francez do të takohet me homologun ukrainas Volodymyr Zelensky dhe me udhëheqës të tjerë për të diskutuar krizën ndërkombëtare dhe situatën në Lindjen e Mesme.

Në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Macron pritet të mbështesë forcimin e bashkëpunimit shumëpalësh dhe të aleancave mes shteteve.

Presidenca franceze ka shprehur shqetësimin për dobësimin e efektivitetit të mekanizmave shumëpalësh, duke vënë në dukje edhe përçarjet në rritje mes pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[AfD e ekstremit të djathtë fiton zgjedhjet në Gjermaninë verilindore, CDU nuk hyn në parlament, Merz zotohet të qëndrojë](#)

07:47 Bota

Trump: Rebelët Houthi nuk do sulmojnë SHBA

07:35 Bota

Epoka pas Putinit/ Shtatë emrat që shihen si “trashëgimtarët” e mundshëm të Kremlinit

07:25 Bota

Belgët shijojnë ditën pa makina në rrugët e vendit

22:53 Bota / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.